

Kërkimi i vendit të mësimit të profesionit- si të bëhët më së miri?

Përcaktimi i profesionit

Nëse shkon të kërkosh një vend për mësimin e profesionit/zejes, duhet që profesioni yt të jetë i përcaktuar. Më fjalë të tjera: ti e di çka dëshiron të bëhesh! Kjo është më rëndësi dhe të mundëson që të kërkosh një vend për të cilin je përcaktuar, dhe jo të orientohesh pa planifikuar fare, në vendin e parë që ta gjesh.

Mbledhja e adresave

Tani ti mund të sjellësh përvoja, se cilat ndërmarrje në profesionin tënd të dëshiruar ofrojnë një vend të lirë për mësimin e profesionit gjatë verës që vjen. Për këtë ti ke mundësi dhe mjete të ndryshme në dispozicion:

- Në Këshillimorën për Profesione¹ do të gjesh lista të ndërmarrjeve të cilat kanë mundësi t'i shkollojnë nxënësit/et në profesionin e dëshiruar.
- Në internet janë të dhëna vendet e lira për mësimin e profesionit.
- Vende të lira për mësimin e profesionit mund të gjesh në revista falas dhe gazeta ditore.
- Shumë nxënës dhe nxënëse vijnë deri te një vend i lirë për mësimin e profesionit, përmes të njohurve ose të afërmeve. Shfrytëzoni lidhjet dhe miqësitë e mundshme.

Kontakto

Tani i ke adresat e përshtatshme. Lajmërohu te ndërmarrjet të cilat faktikisht kanë vende të lira. Shfrytëzo për kontakt të parë telefonin, ose shko vetë atje. Pastaj, në rastin e përshtatshëm pyet se si mund të konkurrosh. Mënyrat e paraqitjes ndryshojnë nga ndërmarrja në ndërmarrje. Një ndërmarrje e dëshiron një kërkesë me shkrim, ndërsa një tjetër dëshiron që të njoh drejtpërdrejt. Me rëndësi është që të konkurrosh ashtu si ata kërkojnë.

Konkuro

Një kërkesë me shkrim heret apo vonë kërkohet nga të gjitha ndërmarrjet. Ka rregulla të qarta, se si duhet të duket një shkresë e tillë dhe çka përmban ajo. Ti ke mësuar në shkollë apo ndoshta nga prindërit e tu, se si konkurohet me shkrim. Nëse nuk je i/e sigurt, kërko ndihmën e domosdoshme, p.sh. në këshillimorën për profesione. Këtu mund të këshillohesh dhe mund të marrish shembuj të ndryshëm, se si konkurrohet me shkrim. Ja edhe një këshillë: Mundësisht konkurro në shumë vende njëkohësisht. Kështu do t'i zmadhosh shanset tua për gjetjen e një vendi për mësimin e profesionit.

Mbaj evidencë

Është e arsyeshme që ta mbash një kontroll mbi të gjitha aktivitetet e konkurimeve të bëra. Më së miri është që për këtë qëllim të bësh një listë, në të cilën do të shënosh së kur ke konkuruar, se a të kanë

1

Secili kanton e ka së paku një Këshillimorë për Profesione
Adresat mund të merren në shkollë, në komunën tuaj, apo në internet: www.svb-asosp.ch

Këshillimorja për Profesione dhe Qendra Informativë për Profesione ÇIP
është shpesh e njohur me një emër të veçantë ose me një shkurtesë:

Gjermanisht	BIZ, Laufbahnzentrum
Frëngjisht	OP, OSP, OROSP, CIO, CIP, OOF
Italisht	orientamento, UOSP

caktuar ndonjë takim apo deri kur do të informohesh. Kështu ti e din çdo herë se çka është e kryer, prej kujt pret përgjigje dhe kur mund të pyesësh.

Zotëro provimet dhe bisedat

Gjithnjë e më shumë ndërmarrje dhe organizata kërkojnë që të bësh një test të aftësisë. Informohu se si duket ky test në profesionin e dëshiruar dhe çka kërkohet.

Kur të vish deri tek zgjedhja e ngushtë, kryepunëtori/ja do të dëshiroj që të njohë personalisht. Përgatitu me kohë për këtë bisedë prezantuese. Paramendoj pyetjet dhe përgjigjet e mundshme. Nëse je i /e pa sigurt, bisedo me ndokënd. Përshtypja që u mbetet nga kjo bisedë prezantuese, luan një rol shumë më rëndësi. Për këtë paraqitu sa më mirë, tregohu i interesuar dhe i motivuar.

Përballo refuzimet

Situata për kërkimin e vendit për mësim të profesionit në shumë profesione, është e vështirë. Për këtë duhet të llogaritësh edhe me refuzime të kërkesave tua. Mos lejo në asnjë mënyrë që të demoralizohesh. Qendro aty dhe përpigu edhe më tutje. Kërko arsyet e refuzimit. Ndoshta ke mundësi që në të ardhmen të përmirësosh diçka dhe kështu të rrisësh shanset për sukses.

Bëhu fleksibil

Mos këmbëngul vetëm për një profesion. Ndoshta në profesionin e dëshiruar nuk do të gjesh vend për mësimin e profesionit. Atëherë është më rëndësi që për zgjedhje tjera të jesh i/e hapur.

Nëse përkundër përpjekjeve të mëdha, një kohë të gjatë nuk ke gjetur vend në profesionin e dëshiruar, është e domosdoshme që situatën ta analizosh me kujdes. Kërko mundësitë në ndonjë profesion të përafërt, një vit kalimtar, një praktikë, një vit shkollimi gjuhësor etj. Reago më kohë mblidh informata ose kërko ndihmë të nevojshme. Bisedo gjithsesi me këshilltarin ose këshilltaren dhe planifiko veprimet e mëtuajtshme. Kështu, ti do të jesh një hap më afër zgjedhjes së profesionit.